

VENDIM
Nr.396, datë 25.6.2004

**PËR TRANSFERIMIN E MJEDISEVE TË SHTËPISË SË PUSHIMIT TË USHTARAKËVE,
TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES,
NË PRONËSI TË BASHKISË SË SARANDËS DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS
SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT
I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e shtëpisë së pushimit të ushtarakëve në qytetin e Sarandës, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojnë në pronësi bashkisë së Sarandës, që të përdoren si qendër social-kulturore e këtij qyteti.

2. Prona me numër rendor 707 “Shtëpia e pushimit të ushtarakëve” në Sarandë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.

3. Bashkisë së Sarandës i ndalohet t’ia ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ua japë këtë pronë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetari i bashkisë së Sarandës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano